



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE



Date/ 14/08/2025

Nr/ 02/936

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes si dhe në zbatim të thirrjes publike të shpallur më 07.08.2025 nga Komuna e Shtimes në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), për renovimin/rindërtimin e shtëpive private të familjeve të cënueshme, Kryetari i Komunës së Shtimes merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për zbatimin e procedurave të thirrjes publike për projektin "Banimi Social Adekuat- Nën projektet tjera"

2. Komisioni i themeluar përbëhet nga këta anëtarë:

1. Gëzim Gashi – Kryesues
2. Lumnije Aliu – Anëtare
3. Valdete Hasani – Anëtare
4. Sami Januzi – Anëtar
5. Ilir Fejzullahu – Anëtar

3. Komisioni ka për detyrë: Të shqyrtojë dhe verifikojë dokumentacionin e aplikuesve; Të bëjë vlerësimin në përputhje me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike; Të hartojë listën e përfituesve dhe raportin përfundimtar për aprovimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Të sigurojë që procesi të jetë transparent dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4. Komisioni i kryen detyrat mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe objektivitetit si dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Mandati i Komisionit sipas pikës 1 të dispozitivit është i vlefshëm deri në realizimin e plotë të qëllimit të këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Arkivit



Kryetari i Komunes
z.Qemal Aliu